

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E ZONAVE KADASTRALE NË TË CILAT LEJOHET KULTIVIMI I CANNABIS-IT PËR QËLLIM INDUSTRIAL”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i zonave kadastrale në territorin e të cilave lejohet kultivimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale. Objektivi i projektvendimit është kultivimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale vetëm në territore brenda zonave kadastrale të miratuar, me qëllim nxitjen e zonave ku ka pasur eksperimentime përmbytje e kanabisit industrial, si dhe punimit të tokave të lëna djerr, por njëkohësisht garantimin e kontrollit dhe monitorimin nga institucionet përgjegjëse në përputhje me legjislatacionin në fuqi. Subjektet që do pajisen me leje sipas Ligjit Nr.61/2023, “*Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjeksore dhe industriale*” do aplikojnë vetëm nëse njësia e kultivimit është brenda territorit gjeografik të zonave kadastrale të miratuar, dhe nëse plotësohen dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore, sidomos ato që lidhen me vendimin që përcakton standartet e tokave dhe zonave ku kultivohet *cannabis*-it për qëllime industriale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi nuk është në Programin Analistik të Projektakteve që do miratohen nga Këshilli i Ministrave në vitin 2024, por u hartua dhe synohet miratimi për shkak të afateve dhe detyrimeve të Ligjit Nr.61/2023 “*Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjeksore dhe industriale*”. Projektvendimi nuk lidhet me dokumenta politikë apo programin politik të Këshillit të Ministrave.

Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i cannabis-it për qëllim industrial*”

III. ARGUMENTIMI LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr.61/2023, “*Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjeksore dhe industriale*” i cili parashikon miratimin e disa akteve nënligjore, përfshirë dhe këtij vendimi, nëpërmjet të cilës përcakton zonat kadastrale ku lejohet kultivimi/mbjellja e bimës së cannabis-it për qëllime industriale. Miratimi i akteve nënligjore krijon mijedisin e plotë rregullator për kultivimin e bimës së cannabis-it dhe zbatimi i tyre në mënyrë të harmonizuar mundëson kultivimit të bimës për qëllime industriale.

Projektvendimi përcakton zonat kadastrale brenda të cilave do lejohet kultivimi i cannabis-it për qëllime industriale nga subjektet që autorizohen nga ministria përgjegjëse për bujqësinë sipas procedurave të nenit 23 të Ligjin nr.61/2023, “*Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjeksore dhe industriale*”. Pra, parakusht për pajisjen me autorizim dhe më tej ushtrimin e aktivitetit është që njësia e prodhimit të jetë brenda zonave kadastrale ku lejohet kultivimi/mbjellja.

Përcaktimi i zonave kadastrale me vendim të Këshillit të Ministrave i jep mundësinë subjekteve private që synojnë të kultivojnë/mbjellin cannabis për qëllime industriale të përzgjedhin parcelat, tokat apo ambientet e mbrojtura/mbyllura ku pas marrjes së autorizimit do kryejnë aktivitetin.

Nga ana tjetër, miratimi i zonave kadastrale lejon institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese të kontrollojnë dhe monitorojnë në mënyrë efektive kultivimin/mbjelljen në përputhje me rregullat, duke evitar kultivimin jashtë kushteve dhe kritereve ligjore. Theksojmë se kontrolli i kultivimit ka qenë një nga objektivat kryesorë të Ligjit nr. 61/2023, dhe kufizimi në vetem një pjesë të territorit të Shqipërisë, nëpërmjet zonave kadastrale, është një instrumenta me të cilën garantonhet kontrolli.

Me qëllim përcaktimin e saktë gjeografik të zonave kadastrale është bashkëpunuar gjatë hartimit të projektvendimit me Agjencinë Shtetërore për Informacionin Gjeohapsinor dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, është përgatitur harta, e cila do jetë publike, përmban kufijtë e zonave kadastrale brenda të cilave ku mund të aplikohet përmarrje autorizimi për kultivim dhe i shërben subjekteve për identifikimin e tokave ku do kultivojnë/rrisin bimën. Pas hyrjes në fuqi të vendimit harta do publikohet dhe subjektit do kenë mundësi të Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i cannabis-it për qëllim industrial*”

identifikojnë saktësisht dhe në mënyrë transparente zonat në të cilat do kryejnë aktivitetin si në kultivimin tradicional ashtu dhe rritjen në ambjente të mbyllura ose në substrakt.

Procesi i identifikimit të zonave kadastrale u fillua bazuar në të dhënrat dhe informacionin e Programit “*Sistemi i informacionit mbi tokën bujqësore*”, administruar nga Qendra e Transferimit të Tokës Bujqësore Fushë Krujë, institucion në varësi të MBZHR-së. Sistemi përmban të dhëna dhe tregues përcilësitë fiziko - kimike të tokave bujqësore që mundësojnë identifikimin e tokave të përshtatshme përkultivimin bimës së *cannabis-it* përqëllime industriale.

Nga analiza e të dhënave të Sistemit nxirren rekomandime përbimët që mund kultivohen/mbillen në tokat bujqësore, rekomandime jo detyruese pasi të gjitha bimët lejohen të kultivohen, por të dhënrat orientojnë përshtatshmërinë e bimës me tokën. Ligji Nr.61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës *cannabis-it* dhe prodhimit të nënprodukteve të saj përqëllime mjeksore dhe industriale” lejon kultivimin dhe në toka, terrene apo ambiente të mbrojtura/mbyllura, ndaj në këto zona kadastrale lejohet kultivimi edhe në toka jobujqësore. Për këtë arsyesh edhe tokat jo bujqësore në territorin e të njëjtave zona kadastrale ku u identifikuat ato më të përshtatshme janë pjesë e vendimit dhe mund të kryhet mbjellja/rritja. Në total vetëm tokat bujqësore në zonat kadastrale pjesë e shtojcës 1 kanë një sipërfaqe totale prej 60000- 65000 ha, ndërkohë që nëse përdoren dhe tokat jobujqësore sipërfaqja ku mund të kryhet aktiviteti është e tillë që mund të zhvillohet në mënyrë maksimale. Bazuar në të dhënrat e sistemit janë identifikuar zona kadastrale në bashkitë Malësi e Madhe, Cërrrik, Tepelenë, Këlcyrë, Delvinë si dhe qarkun e Kukësit me qëllim lejimin e mbjelljes/kultivimit. Por pas vitit të parë zonat kadastrale do rishikohen varësisht nga rezultatet e vitit të parë.

Përcaktimi i zonave kadastrale është bazuar dhe në historikun e kultivimit, edhe kjo e lidhur me përshtatshmërinë e tokës, kryesisht në Malësinë e Madhe dhe Cërrrik dhe projekzioni është në këto njësi të vetëqeverisjes vendore do jetë interesit më i madh përkultivim/mbjellje nga fermerët dhe shoqëritë tregtare të interesuara. Po ashtu dhe tokat në qarkun e Kukësit dhe bashkitë Tepelenë dhe Këlcyrë, janë të përshtatshme, por njëkohësisht dhe rritet interesit i punimit dhe mbjelljes së tokave në zontat që kanë mbetur pa përdorur. Me lejimin e ushtrimit të këtij aktiviteti synohet rritja e aktiviteteve ekonomike, punësimit dhe të ardhurave në zonat rurale.

Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i cannabis-it përqëllim industrial*”

Zonat kadastrale miratohen çdo vit, pas rezultateve të vitit të parë do të vlerësohet nëse duhet të zgjerohet harta për të dhënë mundësinë e kultivimit në zona të tjera. Theksohet se ky vendim zbatohet në harmoni me parashikimet e vendimit për miratimin e standardeve të tokave në të cilat lejohet kultivimi i cannabisit industrial, vendim i cili synohen të miratohet njëkohësisht me këtë projektvendim. Para dhe gjatë hartimit të projektvendimit është komunikuar me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe janë marrë informacione për të garantuar të mos përfshihen ato zona ku dominojnë zonat e mbrojtura dhe zona me përparësi zhvillimin e turizmit. Në vlerësim është marrë në konsideratë Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 26.7.2028, “Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë” dhe gjithashtu Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.707, datë 21.11.20018, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier”, VKM nr. 708, datë 21.11.2018, “Për regjistrimin dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Vlorë – Sarandë”.

Aktviteti i kultivimit dhe aktivitetet e tjera do të kryhet në njësi kultivimi, në sipërfaqe toke jo më pak se 1 HA. Procedura e marrjes së lejes kryhet sipas nenit 23 të Ligjit Nr.61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjeksore dhe industriale”. Gjatë fazës së aplikimit subjektet do dorëzojnë dokumentacionin nëpërmjet të cilit verifikohet vendodhja e parcelave në raport me kushtëzimet për vendndodhjen e njësisë së kultivimit.

Një element i rëndësishëm është mundësia e kontrollit efektiv të Policisë së Shtetit të kultivimit të bimës së *cannabis*-it me qëllim evitim e shkeljeve. Me identifikimin e zonave kadastrale dhe procesin e dhënies së lejes, Policia e Shtetit ka informacion të mjaftueshëm për parashikimin e kontrolleve dhe monitorimin e kultivimit nga fermerët dhe subjektet tregtare. Po ashtu gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e lejes për të ushtruar aktivitetin e kultivimit të *cannabis*-it industrial, MBZHR bashkëpunon me Policinë e Shtetit për të dhënë leje vetëm për fermerë dhe subjekte që plotësojnë kriteret ligjore për ushtrimin e këtij aktiviteti.

*Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i *cannabis*-it për qëllim industrial”*

Miratimi i akteve dhe fillimi i kultivimit dhe tregtimit do të ketë efekte pozitive :

- Për rritjen e eficencës së përdorimit të tokave bujqësore dhe shtimin e sipërsfares së tokës së punueshe,
- Nxitjet punësimi dhe rriten të ardhurat për të punësuarit dhe njëkohësisht të ardhurat në buxhetin e shtetit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi miratohet në përputhje me nenin 12 pikë 3, të Ligjit Nr.60/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës *cannabis-it* dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjeksore dhe industriale”.

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në harmoni me legjislacion vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektvendimi nuk kryen përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi përbëhet nga 3 nene dhe shtojca bashkëlidhur që është pjesë përbërëse e tij.

Neni 1 përcakton zonat kadastrale ku do lejohet kultivimi, të identikuara në shtojcën bashkëlidhur që bëhet pjesë e këtij vendimi.

Në nenin 2, përcaktohet se, kultivimi kryhet në përputhje me kufizimet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e standardeve për zonat dhe parcelat e tokës në të cilat do të lejohet kultivimi i bimës së cannabis-it për qëllime industriale

Neni 3, përcakton organet që ngarkohen për zbatimin e vendimit.

Vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i *cannabis-it* për qëllim industrial”

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Ngarkohet për zbatimin e vendimit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabisit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

I. Projektvendimi u hartua nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe u kordinua me Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabisit. Projektvendimi u dërgua për mendim dhe bashkërendim në ministritë e linjës, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it.

1. Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it me shkresën dha komente dhe sugjerime:

U reflektua sugjerimi për emërtesën e shtojcës bashkëlidhur. Po ashtu u kryen ndryshimet në shtojcë, sipas sugjerimeve për qarkun, njësitë administrative dhe renditjen.

Lidhur me pikën 1, referimi për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, zonat e mbrojtura, ato janë të parashikuara në projektvendimin për përcaktimin e standardeve. Në versionin e parë të këtij projektvendimi u parashikua të integroheshin përkufizime me largësinë dhe elementë të tjera por u vendos të vijohej vetëm me përcaktimin e zonave kadastrale. Ligji nr.61/2023, autorizon Këshillin e Ministrave të miratojë vetëm zonat kadastrale ku do lejohet kultivimi me qëllimin kultivimin e kontrolluar, ndërsa përcaktimi i rregullave të tjera në këtë tekstu mund të jetë përtej autorizimit ligjor. Theksojmë se zonat kadastrale përfshijnë brenda kufijve të tyre jo vetëm toka bujqësore, por dhe zona urbane (shkolla, apartamente, qendra shënetësore, mjedise sportive etj) – ku nuk kultivoohen bimë si pjesë e një njësie ekonomike. Kultivimi ose rritja do bëhet në toka bujqësore ose toka të tjera, ambiente të mbrojtura ose të mbyllura, që plotësojnë paraskushtin të jenë brenda zonave kadastrale, por plotësojnë dhe kriteret e tjera, një ndër to pajisja me autorizim. Nga vlerësimi në harmoni i përcaktimeve ligjore, këtij vendimi dhe vendimit për standartet, del qartë për subjektet që synojnë ushtrimin e aktivitetit dhe agjencitë që do monitorojnë aktivitetin.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i cannabis-it për qëllim industrial”

Ndërkojë për zonat e mbrojtura dhe zonat me përparësi zhvillimin e turizmit pengesa për ushtrimin e aktivitetit është e përcaktuar qartë në projektvendimin për standartet. Instrumenti përfundimtar i kultivimit jo në zona të mbrojtura dhe ato me përparësi zhvillimin e turizmit është procesi për autorizim, pra, sa herë ka aplikime për kultivimin në parcela brenda zonave të tilla, pavarësisht se janë në zona kadastrale të miratuara, këto aplikime refuzohen.

- a. MBZHR në bashkëpunim me ASIG kanë përgatitur hartën e cila do bëhet publike vetëm pas miratimit të vendimit, hartë e cila mund të shërbejë për publikim.
- b. MBZHR sqaron se përcaktimi i zonave bazohet nisur nga informacioni që disponon mbi tokat bujqësore dhe përshtatshmërinë e tyre për kultivimin e *canabis-it* për qëllime industriale. Projektvendimi synon që kultivimi të bëhet në zona ku tokat janë të përshtatshme dhe ka pasur kultivim, kryesisht Malësia e Madhe dhe Cërriku. Për sa i përket operatorëve që ushtrojnë aktivitet, nisur nga karakteristikat e tokës që i shërbejnë kësaj bime, zonat ku ka pasur kultivim janë të përfshira në këtë projektvendim. Subjektet po ashtu kanë mundësi të kryejnë aktivitet në vende të tjera por Ligji nr.61/2023 synon kultivimin e kontrolluar dhe për këtë arsy përcaktohen zonat kadastrale. Gjithashtu duhet të theksojmë se përzgjedhja e Qarkut të Kuksit, Bashkive Tepelenë, Këlcyrë është bazuar në sipërfaqet e tokës së papunushme të tyre dhe nuk rrezikojmë zhvillimin e bujqësisë intensive. Duhet sqaruar se në asnjë rast nuk cënohen interesa ekonomikë nga kultvime të mëparshme pasi është kulturë sezionale si çdo bimë tjetër dhe nuk konstatohen investime që humbin vlerën e tyre për shkak të zonave kadastrale.
- c. Për sa i përket sugjerimeve sqarojmë se informacioni që disponon QTTB Fushë Krujë, “*Sistemi i informacionit mbi tokën bujqësore*”, është vetëm për toka bujqësore dhe tregon cilësitë e tokës dhe të dhënat janë përdorur në raport me përshtatshmërinë e tokës. Cdo tokë bujqësore mund të përdoret për kultivim por të dhënat specifike orientojnë femerët të kultivojnë bimë që prodhojnë më shumë në toka me karakteristika të caktuara. Për *canabbisin*, nga të dhënat e sistemit dhe historikut të kultivimit, tokat më të përshtatshme janë pjesë e këtij vendimi dhe nuk cënojnë zhvillimin e buqësisë intensive.

Relacion shpjegues për projektvendimin “*Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i *cannabis-it* për qëllim industrial*”

Projektvendimi nuk ka rregullime mbi procedurat e shqyrtimit të kërkesave, por referimi të procesi i vlerësimit të tyre është sjell si argument që përcaktimet e vendimit duhen parë në harmoni me Ligjin Nr. 61/2023, dhe aktet e tjera ligjore.

Korniza rregullatore garanton përbushjen e qëllimet të ligjit dhe krijon kushte optimale për subjektet e interesuara. Sjellim në vëmëndje se prej shumë vitesh nuk ka kultivim dhe miratimi i vendimeve nxit zhvillimin e sektorit.

Projektvendimi për shkak të sugjerimeve do dërgohet për ribashkërendim te Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Njësitë e Vetqeverisjes Vendore, që dha dakordësinë dhe u ridërgua për bashkërendim, dhe gjithashtu është bashkëpunuar për përgatitjen e hartës. Në vijim të procesit të hartimit të projektvendimit u rishikua numëri i zonave kadastrale pjesë e shtojcës – janë përfshirë ato zona ku është eksperimentuar dhe kultivuar në disa vite, Malësia e Madhe dhe Cerriku, si dhe në toka që kanë përshtashmëri më të madhe, por janë të lëna djerr.

Projektvendimi ridërgohet për bashkërendim në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it, Ministrinë e Turizmit, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencinë Shtetërore të Kadastras, dhe dërgohet për herë të parë në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dha dakordësinë.

3. Ministria e Mbrojtjes dha dakordësinë me sugjerimin që të mos përfshihen tokat në administrim të kësaj ministrie.

Sqarojmë se projektvendimi nuk jep të drejta përdorimi të pasurive të paluajtshme, pronari ose administratori i pronës shtetërore jep të drejta bazuar në legjislacionin sektorial ku jep dhe destinacionin e përdorimit të pasurisë. Gjithsesi në vendimin ku përcaktohen standartet e zonave dhe parcelave është parashikuar që përjashtohen zonat ushtarake.

4. Ministria e Financave dha dakordësinë parë në këndvështrimin buxhetor. Sqarojmë se projektvendimi nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i cannabis-it për qëllim industrial"

5. Ministria e Brendshme dha dakordësinë.
6. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dha dakordësinë me sugjerime.
- a. Për sa i përket përjashtimit të zonave të mbrojtura dhe ato me përparësi zhvillimin e turizmit, sëqerajmë se pavarësisht se zonat kadastrale mund të kenë në territorin e tyre zona të mbrojtura ose me përparësi zhvillimin e turizmit, çdo kërkësë për autorizim/leje ushtrimi aktiviteti refuzohet nëse toka e parashikuar ndodhet në zona të tilla. Ky vendim do zbatohet në harmoni me vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e standardeve dhe më tej do verifikohet dokumentacioni gjatë aplikimit për leje sipas nenit 23 të ligjit nr.61/2023. Pra janë të gjithë instrumentat për të garantuar që kultivimi të mos bëhet në zona të mbrojtura ose me përparësi zhvillimin e turizmit. Theksojmë se në projektvendimin e ripunuar u shtua pika 2 që garanton zbatimin në harmoni me vendimin e standardeve, çka vlen dhe për komentin e MTM-së.
- b. Argumentimi sipas shkronjës *a* vlen dhe për zonat kadastrale të cituara në shkresën kthim përgjigje.
7. Ministria e Drejtësisë dha dakordësinë me sugjerime.
- a. Nga baza ligjore u hoq neni 102 I Kushtetutës.
- b. Nga dispozita referuese u hoqën subjektet private që ngarkohen për zbatimin e vendimit. Neni 2 në projektvendimin e ripunuar është numërtuar si neni 3.
- c. Në aneks janë shtuar të dhënat për zonat kadastrale, duke shtuar qarkun, bashkinë dhe njësinë administrative.

II. Projektvendimi i ripunuar dërgohet për ribashkërendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Agjencinë Shtetërore të Kadastratës dhe Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Relacion shpjegues për projektvendimin "*Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i cannabis-it për qëllim industrial*"

**IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
BUXHETORE**

Projektvendimi nuk ka kosto dhe efekte financiare për buxhetin e shtetit.



Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i cannabis-it për qëllim industrial"